

RAPORT I SHKURTËR

*Debat për
dokumentin e
politikave “Drejt një
politike kulturore
në Kosovë”*

09.11.2015, Prishtinë



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura

Rrjeti i organizatave të pavarura të
kulturës të Kosovës

www.forumikulturor.net



**FORUMI
KULTUROR**

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës

Rrjeti i organizatave të pavarura të kulturës të Kosovës
www.forumikulturor.net

Prodhimi i këtij dokumenti është mundësuar me ndihmën e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe Olof Palme International Center e mbështetur nga Qeveria Suedeze.

“Ky publikim u prodhua me ndihmën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi vetëm e Forumit Kulturor dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet mendimet e Bashkimit Evropian”

RAPORT I SHKURTËR

Debat për dokumentin e politikave “Drejt një politike kulturore në Kosovë”



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



SWEDEN

Më 3 nëntor 2015 Forumi Kulturor ka organizuar një debat publik me rastin e publikimit të raportit të politikave me titull “Drejt një politike kulturore në Kosovë”. Raporti është hartuar në bashkëpunim me Grupin për Studime Juridike dhe Politike.

Qëllimi i këtij debati ishte paraqitja e të gjeturave të Raportit të politikave, nisja e diskutimeve për menaxhimin e pavarur të institucioneve të kulturës, si dhe përpjekja për identifikimin e sfidave dhe alternativave më të mira të politikave për përmirësimin e gjendjes. Në këtë debat morën pjesë përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, shoqëria civile dhe mediet.

Panelin e udhëhoqi znj. Shqipe Hajredini, e cila është gjithashtu bashkautore e Raportit të politikave. Folësit në panel kanë qenë znj. Ebba Lekvall – hulumtuese në Grupin për Studime Juridike dhe Politike (bashkautore e Raportit, znj. Vjollca Aliu – përfaqësuese e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe Florent Mehmeti, kryesues i Forumit Kulturor.

Gjetjet kryesore dhe pikat e paraqitura nga folësit janë të cekura më poshtë:

Shqipe Hajredini ka theksuar qëllimin dhe fushëveprimin, si dhe ka elaboruar arsyetimin e politikave të kulturës, ashtu siç janë identifikuar në raport:
-Për shkak të kom-

pleksitetit të kulturës dhe vistririt të gjerë të sektorëve ekzistues, në raport mbulohen vetëm fushat e kulturës ku mund të propozohen veprimet e menjëhershme të politikave;

-Po ashtu, çështjet e trashëgimisë kulturore, të rinisë dhe të drejtave të autorit, edhe pse relevante, janë lënë jashtë fushëveprimit të raportit;

-Modelet e rregullimit të politikave mund të ndryshojnë prej vendit në vend varësisht prej shumë faktorëve. Përshtatja e modelit për Kosovë nënkupton analizë të kujdesshme të kontekstit historik, vlerësimin e mangësive ekzistuese në çdo sektor specifik, rishikimin e legjislacionit dhe financim të duhur.

Ebba Lekvall (GSJP) ka diskutuar rreth përmbajtës së raportit, duke theksuar gjetjet e identifikuar aktuale.

-zgj. Lekvall vuri në pah se raporti duhet të shërbejë si udhëzues për institucionet e kulturës në Kosovë përkthazi me shqyrtimin e mundshëm të politikave aktuale, si dhe instrument për diskutimin e çështjeve kryesore në disa fusha të kulturës që janë dëshmuar si jofunksionale.

-Gjetjet kryesore të raportit janë të ndara në grupe, ku shënjestrohen çështjet kryesore, duke përfshirë: hartimin e politikës kulturore, reformat juridike, financimin, çështjet e bordit dhe të menaxhmentit, si dhe përmirësimin e kapaciteteve të resurseve njerëzore.

-Derisa disa nga reko-

mandimet kërkojnë angazhim direkt të institucioneve, nevojitet një platformë e dialogut mes këtyre të fundit dhe shoqërisë civile.

-Po kështu, është vërejtur se MKRS-ja ka nevojë të hartojë një politikë të qartë të kulturës, përmes së cilës caktohen qëllimet e qarta për jetë kulturore në Kosovë, në bazë të të cilës do të caktohen objektivat dhe veprimet. Këto qëllime të politikave duhet të bazohen në parime të lirisë së shprehjes, tolerancës zero për korrupsionin dhe marrëdhënies konsekuente mes qeverisë dhe sektorit të kulturës si atij publik, ashtu edhe të pavarur.

-Identifikimi i palëve të kulturës në Kosovë duhet të bëhet nga një palë e pavarur me interes, me përfshirje të

të gjitha grupeve të skenës së kulturës. Procesi duhet të përfshijë konsultim të gjerë të të gjitha palëve të përfshira.

-Reformat ligjore duhet të përfshijnë rishikimin e të gjitha akteve juridike sipas nevojës me qëllim të shmangies së dyfishimit dhe të thjeshtësim-it të kornizës aktuale juridike në mënyrë që ajo të jetë e përshtatshme për jetën kulturore në vend dhe në përputhje me praktikën ndërkombëtare.

-Krijimi i informatave të qarta për gjetjen e mundësive për sektorin e pavarur të kulturës. Përveç kësaj, duhet të hartohen kritere të qarta për ndarjen e fondeve për projekte të kulturës, ndërsa për vendimet lidhur me mosfinancimin e projektit të caktuar duhet të jepen arsyet për refuzimin e

aplikacionit.

-Sa i përket çështjes së bordeve dhe të menaxhmentit, institucionet duhet të sigurohen që persona të kualifikuar të emërohen në borde të institucioneve publike të kulturës, dhe mund të shqyrtojnë mundësinë e motivimit të çdo anëtari të bordit në vendimin e publikuar, në vend që të cekin emrat e çdo anëtari të ri.

-Kapacitete njerëzore në MKRS dhe në komuna mund të përmirësohen duke angazhuar njerëz me përvojë paraprake në sektorin e kulturës apo me diploma nga fusha e menaxhimit të kulturës.

Vjollca Aliu (MKRS) u pajtua me rekomandimet e cekura në raport. Megjithatë, ajo vuri re se pavarësisht faktit se në raport nuk ceken çështjet specifike lidhur me trashëgiminë kulturore, sfidat e përbashkëta brenda sektorit të kulturës ende mbesin.

-Ministria duhet të përpiqet të përfshijë dhe të angazhojë në mënyrë aktive në procesin e ndarjes së buxhetit që nga fazat fillestare, pasi që Korniza afatmesme e shpenzimeve t'iu dërgohet institucioneve.

-Ministria ka kufizime financiare që vazhdimisht të angazhojë staf më profesional dhe të rrisë ekspertizën e saj në fushën e kulturës.

-Duhet të ekzistojnë kriteret për financimin e kul-

turës. Përderisa akti ligjor për rregullimin e subvencioneve nga MKRS-ja duket të jetë premtues, duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje përmirësimit të këtij procesi.

-Ekzistojnë kufizime nga Ministria e Financave në ndarjen e përgjithshme të buxhetit për kulturë, gjë që ndikon edhe në ndarjen e mjeteve për nivelin lokal.

Florent Mehmeti (Forumi Kulturor) theksoi nevojën për **“një vizion të qartë në kulturë”**. Ai vërejti se një vizion i tillë nuk ka ekzistuar në formë të shkruar në Ministri në pesëmbëdhjetë vitet e fundit, por se kjo nuk nënkupton se Ministria nuk ka pasur një agjendë kulturore. Megjithatë, kjo agjendë kryesisht ka qenë

e ndërlidhur me agjendën e partisë udhëheqëse.

-Gjendja e tanishme në kulturë vjen gjithashtu edhe si rezultat i mungesës së angazhimit prokativ nga ana e komunitetit të artistëve.

-Më shumë kompetenca në menaxhimin ditor dhe në politikat afatgjata duhet t'iu jepen udhëheqësve /menaxherëve të emëruar të institucioneve të kulturës.

-Ministria duhet të humtojë forma dhe modalitete të tjera në aspekte organizative lidhur me financimin e kulturës. Si shembull mund të merret forma e tanishme e financimit e krijuar nga Komuna e Prishtinës. Këto modalitete mund të merren parasysht me rastin e hartimit të politikave të ardhshme.

-Qëllimet afatgjata në kulturë duhet të pasqyrohen në një strategji të përbashkët, të cilën Ministria tanimë e ka filluar. Ky dokument nuk duhet të jetë dokument i ndarë sektorial, por më shumë një plan gjithëpërfshirës ku pasqyrohen të gjithë sektorët e kulturës.

Komentet e pjesëmarrësve

Pyetje e gazetarit: A kanë ndikuar politikat ad-hok në hartimin e politikave të kulturës. Këtu u argumentua se kjo është njëra nga arsyet kryesore pse Kosova ende ballafaqohet me sfidat themelore institucionale dhe të menaxhimit që kanë ndikuar në proaktive dhe inovative në kulturë.

Drejtoresha e filmit (që punon në Republikën Çeke) shprehu zhgënjimin e saj se si politikat e teatrit dhe teatri në përgjithësi është (keq) menaxhuar dhe financuar (dobët). Ajo madje e kritikoi edhe mënyrën se si trajtohen ngjarjet e kulturës nga transmetuesi nacional publik. Qytetarëve nuk u ofrohen programe cilësore për kulturë, gjë që në mënyrë të tërthortë ndikon në perceptimin e tyre për artistët dhe profesionalizimin e tyre, shtoi ajo.

Përfaqësuesi i MKRS-së deklaroi se ekzistojnë disa nisma legjislative, të cilat do të ndikojnë në pavarësinë e institucioneve të kulturës dhe do të rrisin qëndrueshmërinë e tyre. Strategjia e përbash-

kët për kulturë do të jetë ajo e reagimeve afatshkurtra në përmirësimin e kulturës në Kosovë. Në këtë strategji duhet të verifikohen sfidat dhe të trajtohen objektivat afatgjata.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit European në Kosovë



Implementuar nga:





forumikulturor.net
facebook.com/ForumiKulturor
twitter.com/forumikulturor